REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
SEKTORI I SHERBIMIT SOCIAL

Nr____Prot Poliçan më 22.08.2025

RELACION

PËR

MIRATIMIN E PLANIT VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE TË BASHKISË POLIÇAN PËR VITET SHTATOR 2025- 2028

KESHILLIT BASHKIAK :

Në mbështetje të ligjit 139/2015 *''Për vetqeverisjen vendore''* ***Ligji Nr.9970, datë 24.7.2008*** *''Për Barazinë Gjinore në Shoqëri''* , **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore'** , Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim *''Konferenca e Katërt Botërore për Gratë: Aksion për Barazinë, Zhvillimin dhe Paqe'n*, **,Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore** , ***Konventa e Këshillit të Europës*** *''Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje* , **Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.**

Vizioni

Vizioni i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore në Bashkisë Poliçan e lidhur logjikisht me Strategjinë për Barazinë Gjinore "SKBGJ 2021-2030" **Një shoqëri e cila vlerëson barazinë dhe drejtësinë gjinore si kushte të domosdoshme drejt zhvillimit të qendrueshëm social, ekonomik e politik të vendit, fuqizon të gjithë individët për të gëzuar të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës, nuk lejon që askush të mbetet pas, si dhe që mbështetet në parimin e tolerancës zero kundër praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke ndëshkuar dhunuesit dhe duke mbrojtur, rehabilituar e riintegruar personat e dhunu**përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë

gjithë jetës; pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas ku të gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës.

Misioni

Misioni i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore të Bashkisë Poliçan është të zhvillojë dhe zbatojë një sistem të integruar dhe gjithëpërfshirës shërbimesh sociale për barazinë Gjinore, që përmirëson kushtet e jetesës dhe siguron mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin e të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social qytetarëve/qytetareveetj.

Në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, institucionet publike dhe sektorin privat, plani synon të krijojë mundësi për rintegrim dhe fuqizim të këtyre grupeve, duke respektuar identitetin e tyre kulturor dhe duke garantuar një jetesë dinjitoze dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë individët në çdo njësi administrative të bashkisë.

Procesi i Hartimit të Planit

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore është realizuar në bashkëpunim me aktorët lokalë dhe përfshirja e komuniteteve është garantuar përmes analizës së të dhënave demografike dhe statistikore nga Censusi 2023 dhe regjistri i gjendjes civile. Gjithashtu, janë organizuar tavolina të rrumbullakëta me grupet e interesit.

Parimet që udhëheqin Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore të Bashkisë Poliçan janë të fokusuara në përfshirjen e plotë, theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cenueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuara, të moshuara, azilkërkuese, etj., pra **nga të gjitha grupet** në shoqëri.

Plani respekton të drejtat e njeriut dhe identitetin kulturor, duke promovuar transparencën, efektivitetin dhe qeverisjen e mirë. Fokusi kryesor është në ofrimin e mbështetjes për grupet përfshirë edhe nga grupe të cenueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë, ndërsa bashkëpunimi me aktorët lokalë dhe kombëtarë është thelbësor për realizimin e suksesshëm të objektivave, në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare

Qëllimi dhe Objektivat

Qëllimi i Planit VVBGJ të Bashkisë Poliçan është të ndërtojë një sistem të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të shërbimeve Vendore të Veprimit për Barazinë Gjinore në shërbimet sociale, i cili synon përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimin e mbrojtjes për të gjithë qytetarët. Plani do të përqendrohet në fuqizimin e individëve nga grupet më të cenueshme dhe të margjinalizuara, duke ofruar mundësi rintegrimi dhe përmirësimi të jetës për ata që përballen me sfida të ndryshme, përfshirë fëmijët, të rinjtë, të moshuarit, gratë dhe vajzat, individët me aftësi të kufizuar, si dhe ata që kanë qenë viktima të dhunës ose trafikimit. Gjithashtu, do të adresohen nevojat e individëve nga komuniteti rom dhe egjiptian duke krijuar një ambient mbështetës që garanton dinjitet dhe akses në shërbime për të gjithë.

Plani VVBGJ për Gusht 2025- 2028 përmban një sërë objektivash dhe masash konkrete:

Drejtimi :1

Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë Gjinore

Rezultatet e vpritëshme 1a: Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.

I.b. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe perspektiva gjinore e përfshirë në politikat dhe planet e bashkisë.

Objektivi specific :I.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.

Masa kryesore për arritjen e këtij objektivi është përgatitja e PVVBGJ nga grupi I punës I ngritur me urdhër të Kryetarit,miratimi i rregullores së funksionimit të Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie (ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë), përgjatë gjithë zbatimit të PVVBGJ, përgatitja e mjeteve/formateve të unifikuara për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë, moshës, etj., për aktivitetet e zhvilluara në zbatim të këtij PVVBGJ, për t'u përdorur nga secila drejtori në bashki. Organizimi i takimeve periodike me partnerët dhe grupet e interesit mbi zbatimin e PVVBGJ dhe nevojën për përditësim të objektivave të tij. miratimi nga Këshilli Bashkiak ,publikimi I tijë në faqen e internetit

Kjo do të realizohet nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie për monitorimin dhe adaptimin e këtij PVVBGJ

Fondi:768 000 lek, të cilat do të mbulohen nga Bashkia.

Drejtimi 2 :

Rritja e nivelit të sigurisë mbrojtjes e eficeces të qasjes shumë sektoriale të koordinuar për gratë, të rejat, vajzat si dhe burrat ,të rinjtë e djemtë në hapsirat publike e private.

Rezultatet e pritëshme :II.a. Informimi dhe elementët e sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike e private, të rritura ndjeshëm.

II.b. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe eficent.

Objektivi speifik :II.1. Përmirësimi i elementëve të sigurisë, përshtatshmërisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike "

Drejtimi synon rivitalizimin e shërbimit ekzistues për informimet tranjnimet e stafit dhe NJA-ve mbi elementët kryesorë të auditimit për sigurinë dhe përshtatshmërinë në hapësirat publike, Takime në NJA dhe lagje me gra, të reja, vajza, burra, të rinj dhe djem, për të diskutuar mbi nivelin e sigurisë/pasigurisë që kanë në hapësirat publike, adresimi në KVSP i problematikave të evidentuara mbi sigurinë në hapësirat publike, takime informuese me nxënëset dhe nxënësit mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm , trajnim i përbashkët i MKR, GTN dhe KVSP mbi trajtimin e rasteve të ndryshme të dhunës në hapësirat publike e private, ofrimi i shërbimeve mbështetëse dhe koordinuese për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje,

Fondi: 225 000 Lek,të cilat do të mbulohen nga Bashkia,

Drejtimi i 3:

Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm duke shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga tranzicioni i gjelbër (mjedsisor) dhe ai dixhital

Përshkallëzimi i veprimeve për të sfiduar steriotipet gjinore për punësim dhe për të balancuar sipas mundësive jetën pfofesionale me atë personale dhe nevoën për përkujdesje për familjarët në varësi

Mbledhja e informacionit periodik mbi vajzat dhe të rejat që studiojnë në shkencë, teknologji, inxhinieri e matematikë, si dhe mbi të rejat, gratë, të rinjtë e burrat e punësuar në profesione "jo tradicionale, Takime informuese me punëdhënësit dhe punëkërkueset/punëkërkuesit e papunë mbi programet ekzistuese të nxitjes së punësimit dhe përfitimet grupe të ndryshme në nevojë, përfshirë të rejat/rinjtë me ide inovative e që duan të integrohen në tregun e punës, . Takime informuese me mësueset dhe mësuesit, si dhe me nxënëset dhe nxënësit e shkollave 9-vjeçare e të mesme mbi rëndësinë e zgjedhjes së profesioneve jo tradicionale, si dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së vajzave e të rejave në shkencë, teknologji, inxhinieri e matematikë

Fondi: 500 000 Lek, nga të cilat 200 000 Lek mbulohen nga Bashkia,dhe 300 000 lekë nga donatorë

Drejtimi 4: Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficences së qerasë shumë sektoriale të koordinuar për gratë ,të rejat vajzat si dhe burrat ,të rinjtë djemtë,në hapësirat publike e private.

Rezultatet e pritshme: IV.a. Informimi dhe elementët e sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike e private, të rritura ndjeshëm.

IV.b. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe eficent.

Objektivi specifik: IV.1. Përmirësimi i elementëve të sigurisë, përshtatshmërisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike, si dhe rritja e informimit mbi Rezolutën 1325 "Gruaja, Paqja, Siguria"

Fondi: 820 000 Lek, nga të cilat 420 000 Lek mbulohen nga Bashkia pjesa tjetër 400 000 Lekë mbulohet nga donatorë të ndryshëm.

Sfidat dhe Mundësitë

Pavarësisht sfidave, si mungesa e burimeve financiare dhe nevoja për riorganizim të sektorit social, mundësitë për bashkëpunim me organizata ndërkombëtare dhe partnerë ofrojnë një bazë të qëndrueshme për realizimin e planit.

Vlerësimi i Kostove

Plani përmban një vlerësim të detajuar të kostove, duke përfshirë burimet njerëzore, shpenzimet operacionale dhe infrastrukturën e nevojshme për shërbimet sociale.

Konkluzion dhe Rekomandim

Duke vlerësuar rëndësinë e Planit VVBGJ për përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve, propozojmë që Këshilli Bashkiak të miratojë PVVBGJ për periudhën Shtator 2025 -Dhjetor 2028, duke garantuar një angazhim të qëndrueshëm për realizimin e tij.

Pergjegjes i Sektorit te Shërbimit Social

Pellumbesha Boduri

KRYETARI I BASHKISË
Adriatik ZOTKAJ